



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1492, datë 24.01.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Albtelcom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.01.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Albtelcom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1 dhe neni 60 e vijues, pika te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa nr. CEO/004E.Xh., datë 10.01.2011 e Vodafone Albania sh.a;
 - Deklarate e Drejtorit të Pergjithshëm të Vodafone Albania sh.a;
 - Shkresa e datës 23.11.2010 e Vodafone Albania, drejtuar Albtelecom sh.a;
 - Amendament nr.1 i Marrëveshjes së Interkoneksionit Shtator 2010;
 - Shkrese e datës 07.12.2010 e Vodafone Albania, drejtuar Albtelecom sh.a, për dijeni AKEP;
 - Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
- si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Vodafone Albania sh.a me shkresë nr.CEO/0123/exh, datë 23.11.2010 i drejtohet Albtelecom sh.a, të amendojnë Marrëveshjen e Interkoneksionit dhe zbatimin e Vendimit nr.1452, datë 22.11.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP. Meqënëse Marrëveshja ekzistuese ka mbaruar më datë 31.08.2010, Vodafone kërkon që në përputhje me detyrimet rregullatore që përcakton ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të firmoset marrëveshja e re e interkoneksionit. Gjithashtu Vodafone, konfirmon se ekzistojnë të gjitha kushtet teknike për lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit, pasi kapacitetet e interkonektimit midis dy subjekteve janë në operativitet të plotë funksional;
2. Me shkresë nr.CEO/0127/E.Xh., datë 07.12.2010 Vodafone Albania sh.a i drejtohet përseri Albtelecom sh.a, duke kërkuar lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit sipas versionit të Amendamentit të Marrëveshjes së datës 01.06.2010. Vodafone Albania, insiston në çështjet e mëposhtme rreth përmbajtjes së marrëveshjes së interkoneksionit;
 - a) Çështja e klasifikimit të trafikut që terminohet në zonën e Tiranës si trafik lokal. Argumenti i paraqitur nga Albtelecom (shkresa nr.4059/2 prot, datë 04.11.2010) se interkoneksioni realizohet në centralin tranzit të Albtelecom nuk ka vlerë, duke qënë se ky central është në zonën e Tiranës;
 - b) Lidhur me pretendimin e Albtelecom, se zbatimi i diferencimit në tarifa zbatohet vetëm për operatorët alternative me rrjete fikse. Ky argument nuk qëndron nga pikëpamja ligjore e rregullatore, sepse Albtelecom thjesht shet shërbimin e terminimit në rrjetin e tij, pa diferencuar nëse trafiku është i origjinar në rrjet fikse apo mobil, sepse në rast të kundërt ky do të ishte diskriminim nga ana e

Albtelecom. Albtelecom duhet ta trajtojë shërbimin e terminimit të thirrjes pa diskriminim si operatoreve celulare ashtu dhe operatoreve fiks;

- c) Albtelecom përmend faktin se nuk mund të terminohen thirrje në centrale lokale pa kosto shtesë për Albtelecom. Sipas Vodafone, ky nuk përbën argument, duke qënë se vetë Albtelecom zgjedh që të gjithë trafikun hyrës nga Vodafone Albania ta marrë në centralin tranzit (pa dalluar për trafikun me destinacion zonën e Tiranës). Pretendimi i kostove shtesë për një rast të tillë nuk është shumë bindës dhe vetë struktura e tarifave të miratuara nga AKEP nuk diferencon nëse pika e interkoneksionit është në central tranzit apo lokal e rajonal;
 - d) Për sa i përket praktikës shumëvjeçare të Albtelecom që mbështet terminimin e padiferencuar në segment dyfish, Vodafone i qëndron argumentit të saj se fakti që është mbajtur një qëndrim i tillë më parë, nuk nënkupton se tani që tarifat e Albtelecom janë rritur do të vazhdohet i njejti qëndrim;
 - e) Në versionin e fundit të Amendamentit të Marrëveshjes së Interkoneksionit, është parashikuar dhe e drejta për të terminuar thirrje të origjinuara nga abonentë Albtelecom nëpërmjet Operatoreve të Shërbimit me Karta të Parapaguara. Vodafone Albania do të mundësojë terminimin e këtyre thirrjeve tek rrjeti i saj sapo Albtelecom të japë kopje të marrëveshjeve të vlefshme me këta operatorë që reflektojnë çmimet në fuqi të Albtelecom sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a me shkresën nr. CEO/004E.Xh., datë 10.01.2011 në përputhje me pikën 1, neni 120 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me rregulloren e mosmarrëveshjeve miratuar me VKD nr. 1296 date 11.06.2010 pas përfundimit të afateve ligjore të parashikuara për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit ka paraqitur ankim administrativ pranë AKEP;

Për sa më sipër, Vodafone Albania sh.a në ankimin e tij kërkon:

AKEP të detyrojë Albtelecom sh.a të zbatojë Vendimin nr.1348, datë 26.07.2010 të Këshillit Drejtues dhe të pranojë zbatimin e tarifës së terminimit rajonal prej 2.5 lek/min dhe 0.83 lek/thirrje për të gjitha thirrjet e origjinuara në rrjetin e Vodafone Albania të terminuara në centralin rajonal të Albtelecom bazuar në vendndodhjen gjeografike të pikës fundore në rrjetin Albtelecom ku terminohet thirrja.

- a) AKEP të lëshojë një Urdhër për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit midis Vodafone Albania dhe Albtelecom në përputhje me nenin 60 të ligjit 9918, datë 18.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
 - b) Mënyra e re e tarifimit të pasqyrohet edhe në ORI-n e ri të Albtelecom që do të miratohet nga AKEP;
4. AKEP për sa më sipër konsideron se Albtelecom sh.a, në bazë të VKD nr.1348, datë 26.07.2010 “Për përcaktimin e sipërmarresit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në

treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg ka detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashket të faciliteteve të rrjetit, si dhe në zbatim të nenit 50 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 zgjidhja e mosmarrëveshjes mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a.;
 2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jetmir Braha Anëtar
 - Florida Çela Anëtar
 - Xhenisa Nela Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 3. Të njoftohen palët e interesuara Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**